



FTESE

Në 21 Gusht 2019 ka hyrë në fuqi ligji “*Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë*”. Ky ligj vendos procedurat për ushtrimin e nismës ligjvënëse nga 20 000 zgjedhës dhe synon përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse. Ai krijon mundësi për të gjithë shtetasit me të drejtë vote dhe për organizatat e shoqërisë civile, të propozojnë projektligje në Kuvend.

Në këtë kuadër, QNL ju fton të merrni pjesë në diskutimin me temë:

“Njohja dhe zbatimi i ligjit ‘Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve’ në kuadrin e konsolidimit të Shtetit të së Drejtës”

Në mjediset Shtëpia e Evropës, Tiranë

(Pranë Radio-televizionit Publik Shqiptar)

Dt. 21.11.2019, ora 11.00-13.30

Ky aktivitet organizohet në kuadrin e zbatimit të projektit “*Rritja e pjesëmarrjes aktive të shtetasve përmes forcimit të nismës ligjvënëse të shtetasve dhe mjeteve të tjera kushtetuese*”, zbatuar nga QNL me mbështetjen e Fondacionit “*Shoqëria e hapur për Shqipërinë*”.

Aktiviteti zhvillohet me bashkëpunimin e spikatur të Universitetit të Tiranës.

Pjesëmarrja dhe diskutimet tuaja në këtë aktivitet janë shumë të rëndësishme.

Për më shumë detaje, ju lutem gjeni bashkëngjitur programin.

Lutemi konfirmoni pjesëmarrjen tuaj brenda datës 15.11.2019 në adresën avokatore2@yahoo.com

Ju faleminderit!

Av.Aurela Bozo
Drejtoreshë Ekzekutive

PROGRAMI
TRYEZË DISKUTIMI

“Njohja dhe zbatimi i ligjit ‘Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve’ në kuadrin e konsolidimit të Shtetit të së Drejtës”

21 Nëntor 2019

Ora 11.00-13.30

11.00 -11.30 Regjistrimi i pjesëmarrësve, kafe dhe njohja me Mjediset e reja të Shtëpisë së Evropës.

11.30-11.40 Fjala e Mirëseardhjes dhe prezantimi i objektivave të Tryezës.

Moderatore: Aurela Anastasi

11.40-12.10 Rëndësia e njohjes dhe e zbatimit të ligjit “*Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve*”. Procedurat për konsultimin dhe paraqitjen e projektligjit me nismën e zgjedhësve përpara Kuvendit.

Prof.Asoc. Oriona Mucollari, Universiteti i Tiranës

12.10-11.30 Pyetje-përgjigje për të njohur ligjin.

12.30-13.20 **Diskutime** në lidhje me zbatimin e ligjit dhe sfidat në identifikimin dhe ndërmarrjen e nismave ligjvënëse qytetare. Roli i universiteteve në këtë proces.

13.20-13.30 Konkluzione dhe rekomandime të Tryezës

Mbyllja e Aktivitetit